




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-406/14</u>
Nr. fletë Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31-01-2014</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4408/13 për z.Bajram Syla–Kryeshef i Departamentit për “Nëna dhe fëmiju” në Spitalin Rajonal Ferizaj, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4408-13, për Zyrtarin e lartë, z. Bajram Syla – Kryeshef i Departamentit për “Nëna dhe fëmiju” në Spitalin Rajonal Ferizaj – Ministria e Shëndetësisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Bajram Syla fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtari i lartë, z.Bajram Syla, është deklaruar se do t’i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Syla, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Informata mbi biznesin” (DPK-03-261-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, Ordinanca gjinekologjike “Dr.Bajrami”, z.Syla, është tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar të këtij biznesi, dhe ka emruar një “person të besuar” në këtë funksion, ashtu siç e parasheh edhe ligji. Këtë për shkak se z.Syla vazhdon të ushtroj vetëm funksionin e tij publik, si Kryeshef i i Departamentit për “Nëna dhe fëmiju” në Spitalin Rajonal Ferizaj – Ministria e Shëndetësisë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

